



**KANADA, ORGANIZATA
NDËRKOMBËTARE E AVIACIONIT
CIVIL ZHVILLON JAVËN E SIGURISË**
Drejtori i AAC, z. Krislen Keri mori
pjesë në punimet e mbledhjes së
rëndësishme në kuadër të Javës së
Sigurisë...

faqe 4-5



**AAC, VIJON TRADITËN DUKE
MARRË PJESË NË PANAIRIN
"KLIK EKSPLO GROUP"**
Autoriteti i Aviacionit Civil ka
vazhduar traditën e vendosur
tashmë prej vitesh, duke marrë
pjesë edhe në këtë vit...

faqe 6

DHJETOR 2018 - Botimi VIII

posta ajrore



Buletini mujor i Autoritetit të Aviacionit Civil shqiptar

www.aac.gov.al | info@acaa.gov.al

Tel: +355 4 22 51 220



KOMPENSIME

**SHKON NË 700, NUMRI
I KOMPENSIMEVE NGA
KOMPANITË AJRORE**

Kompania Blue Panorama
rezulton me numrin më
të lartë të kompensimeve
ndaj pasagjerëve me 509
të tilla...

faqe 7

STATISTIKA

NUMRI I PASAGJERËVE

Bazuar në të dhënat zyrtare
rezulton se në muajin Tetor janë
regjistruar 226,351 pasagjerë,
10,329 pasagjerë më shumë se e
njëjta periudhë e 2017. Krahasuar
me 2016, shifra është 26,048
pasagjerë më shumë...

faqe 8

TRAJNIME

**AAC ZHVILLOHET
TRAJNIMI NGA
EKSPERTËT LIGJOR
TË JAATO**

Në Autoritetin
e Aviacionit Civil Shqiptar
u zhvillua kursi i radhës me
temë "International Aviation
Law Policy" me pjesëmarrës
specialistë të AAC-së në
kuadër të strategjisë për rritjen
e kapaciteteve të stafit të
brendshëm...

faqe 10



SFIDAT E SIGURISË NË AEROPORTIN NDËRKOMBËTAR NËNË TEREZA

DREJTORI I AVIACIONIT CIVIL SHQIPTAR KRISLEN KERI, KA MARRË PJESË NË PUNIMET E
KONFERENCËS NDËRKOMBËTARE PËR SIGURINË, E ORGANIZUAR NGA KOMPANIA ICTS ALBANIA,
QË KONTROLLON EDHE DISA ASPEKTE TË SIGURISË NË AEROPORTIN NDËRKOMBËTAR "NËNË
TEREZA". KERI THA SE KOMPANIA QË OPERON NË AEROPORTIN E VETËM SHQIPTAR PREJ 14
VITESH, PAVARËSISHT ANGAZHIMIT DUHET TË PLOTËSOJË TË GJITHË KOMPONENTËT E SIGURISË,
DHE TË MOS MJAFTOHET VETËM ME GJETJET NGA AUDITET...

faqe 2-3

SFIDAT E SIGURISË NË AEROPORTIN NDËRKOMBËTAR "NËNË TEREZA"

DREJTORI I AVIACIONIT CIVIL SHQIPTAR KRISLEN KERI, KA MARRË PJESË NË PUNIMET E KONFERENCËS NDËRKOMBËTARE PËR SIGURINË, E ORGANIZUAR NGA KOMPANIA "ICTS ALBANIA". QË KONTROLLON EDHE DISA ASPEKTE TË SIGURISË NË AEROPORTIN NDËRKOMBËTAR "NËNË TEREZA". KERI THA SE KOMPANIA QË OPERON NË AEROPORTIN E VETËM SHQIPTAR PREJ 14 VITESH, PAVARËSISHT ANGAZHIMIT DUHET TË PLOTËSOJË TË GJITHË KOMPONENTËT E SIGURISË, DHE TË MOS MJAFTOHET VETËM ME GJETJET NGA AUDITET.

Së pari dëshiroj t'ju falenderoj për këtë fjalë përshëndetëse në atë që shpresoj të jetë e para nga shumë konferenca që do të dhe duhet të organizohet në Shqipëri, si shumë të rëndësishme për informimin dhe ndarjen e eksperiencave midis palëve në menaxhimin e sistemeve të aviacionit civil në vend dhe më gjerë. Është kënaqësi për mua të jem dëshmitar i shumë aktiviteteve ndërkombëtare këto kohë, ku nuk mund të kaloj pa përmendur aktivitetet trajnuese dhe dy takimeve të ICAO që do të zhvillohen në Tiranë në dhjetor dhe janar 2019. Për të gjithë të ftuarit që mund t'a hasin për herë të parë termin "siguria në aviacionin" më lejoni t'i referohem Aneksit 17 të ICAO, ku siguria në aviacion përcaktohet si "siguria e pasagjerëve, ekuipazhit, personelit të shërbimit në tokë dhe publikut, në gjithë çështjet që lidhen me mbrojtjen nga aktet e ndërhyrjes së paligjshme në aviacionin civil." Tematikat e kohës në këtë fushë, të diskutuara gjerë dhe hollësisht në forumet dhe konferenca ndërkombëtare ku vendi ynë bën pjesë theksojnë gjithmonë e më shpesh për kërcënimet ndaj sigurisë së aviacionit civil të tilla si ato nga brenda (insider threats), kërcënimet në zonën e hapur për publikun (landside), kërcënimet kibernetike (cyber threats) apo ato nga përdorimi i lëndëve radioaktive, biologjike dhe kimike. Ndërsa të gjithë biem dakord për ndjeshmërinë e nivelit të sigurisë së aviacionit kur planifikojmë të udhëtojmë me avion, publiku i gjerë veçanërisht shqetësohet kur dëgjon për ngjarje, incidente apo ngjarje tragjike si ato të ndodhura në aeroporte në Evropë dhe më gjerë, dhe aq më tepër kur këto shkelje dhe incidente ndodhin në të vetmin aeroport ndërkombëtar që një shtet mund të ketë, si në rastin e vendit tonë. Nuk mund të mohohet fakti që këto ngjarje marrin një mbulim mediatik global, veçanërisht në kohët dixhitale që jetojmë, ç'ka e rrit akoma më tej ndjeshmërinë e njerëzve. Shqipëria është vend anëtar i NATO-së, dhe jemi duke punuar intensivisht për t'ju bashkuar Bashkimit Evropian, ç'ka na bën një vend relativisht të sigurtë dhe këtë nuk e ndiejmë vetëm ne, por dhe ata qindra, mijëra e miliona vizitorë që na vizitojnë çdo vit. Fakti që jemi një vend me risk të ulët, në kuptim të sigurisë, nuk d.m.th. që mos të jemi shumë vigjilent dhe shumë të përgatitur për të përballuar ngjarje të mundshme, të paparashikueshme. Në vijim do vazhdoj të flas për sistemin e sigurisë së aviacionit civil shqiptar dhe sfidat me të cilat të gjithë ne palët e përfshira përballemi



Në Foto:

Drejtori Ekzekutiv i AAC, z. Krislen Keri, gjatë fjalës së mbajtur në punimet e Konferencës Ndërkombëtare të Sigurisë, organizuar nga ICTS Albania.

dhe kemi detyrimin për t'i adresuar sipas standardeve më të mira ndërkombëtare. ICTS Albania, që prej 2005-ës është kompania e kontraktuar nga aeroportit ndërkombëtar "Nënë Tereza", për kryerjen e shërbimeve të sigurisë në përputhje me përcaktimet e Marrëveshjes së Koncesionit (Shtojca 44 e Ligjit "Për ratifikimin e marrëveshjes së koncesionit"), që është dhe i vetmi aeroport në vend dhe si i tillë mbart vëmendjen tonë maksimale. Në 13 vite pune në Shqipëri, patjetër që mund të flitet për arritje të standardeve ndërkombëtare nga ana e ICTS dhe aeroportit, si një nga kompanitë lider në rajon, Evropë dhe botë dhe për këtë jemi me fat. Por për të përfituar sa më shumë nga kjo konferencë, në cilësinë e drejtuesit të Autoritetit Kombëtar Mbikëqyrës së Sigurisë në Aviacion, unë do të preferoja të vë theksin mbi përgjegjshmërinë për adresimin e sfidave që rrjedhin nga detyrimet që ICTS Albania dhe TIA kanë në ruajtjen e një sistemi të vlefshëm dhe robust të sigurisë në aviacion në aeroport. Siç mund të jeni në dijeni, sistemi i sigurisë së aviacionit civil në Shqipëri u godit rëndë në ngjarjen e datës 30 qershor 2016, kur një grup i armatosur arriti të hyjë me automjet në pistë dhe të grabisë nën kërcënimin e armëve një sasi të konsiderueshme valute dhe të largohet pa u dëmtuar. Të tjera ngjarje dhe incidente të sigurisë që janë evidentuar kohë pas kohe (2017-2018) dhe janë bërë objekt i hetimeve të sigurisë nga ana e AAC.

Një nga problemet kryesore që evidentohet lehtësisht në analizën e faktorëve të të ardhurave dhe shpenzimeve për sigurinë në këto 14 vjet menaxhim të ICTS, për të cilën ne jemi të gatshëm të jemi ndërmjetës me aeroportin është mungesa thuajse e dukshme e të gjithë komponentëve të sistemit të menaxhimit. Në masat e marra nga ne si autoritet mbikëqyrës, nuk ka pasur ndonjëherë përshkallëzim të masave me gjobë apo revokim të autorizimeve apo certifikatave të dhëna për personelin e sigurisë, e jo më diskutime për masa më të rënda, si pjesë e mekanizmave përmirësues të sistemit dhe jo me qëllim parësor penalizimin. Periudha e punëve vetëm me raporte gjetjesh dhe mbyllje gjetjesh, të ngelura vetëm në letra, përgjatë këtij viti ka marrë fund, ku në mirëkuptim me palët është përmirësuar sistemi i mbikëqyrjes dhe marrjes së masave, në të mirë të përmirësimit dhe ruajtjes së standardit të vendosur nga ana e operatorit. Për Autoritetin e Aviacionit Civil është e papranueshme dhe e pakuptueshme tejkalimi i çdo afati të arsyeshëm për organizimin e një ushtrimi sigurie apo edhe finalizimin e ri-firmosjes së marrëveshjes së bashkëpunimit me policinë e shtetit. Duke vlerësuar ndjeshmërinë e lartë të publikut, AAC është e angazhuar dhe insiston, që të punohet sistematikisht dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse, jo vetëm ndërmjet subjekteve që kanë përgjegjësi direkte për zbatimin e masave të sigurisë së aviacionit, sipas përcaktimeve të Programit Kombëtar të Sigurisë së Aviacionit, por edhe nga subjektet e tjera që janë të lidhura në mënyrë indirekte për veprimtaritë që kryhen në aeroport. Ka ardhur koha e veprimeve konkrete dhe metodologjia e përdorur duhet të jetë vetëm ajo e analizës së rrënjëve të problemeve (root cause analysis), pa limite dhe kufizime për veprimet e duhura për përmirësimin definitiv të sistemit tonë të sigurisë në aviacion. Të mirëpritura janë fondet e harxhuara për trajnimin e personelit të sigurisë së aviacionit civil (përfshirë dhe ato të ICTS Albania) dhe rritjes së pagave dhe përdorimi i stimuljeve për më të mirët. Të mirëpritura janë edhe investimet për përmirësimin e masave dhe procedurave, standardeve operacionale, apo ato për blerjen e pajisjeve të sigurisë. Autoriteti i Aviacionit Civil mirëpret iniciativat për analizimin në detaj të faktorëve që mund të ndikojnë në ruajtjen e standardit të duhur të punës në këtë fushë kritike, përfshi këtu analizën e faktorëve të të ardhurave dhe shpenzimeve për sigurinë, një çështje midis Aeroportit dhe ICTS, dhe jemi të gatshëm të



Në Foto:
Drejtori Ekzekutiv i AAC, z. Krislen Keri, gjatë fjalës së mbajtur në punimet e Konferencës Ndërkombëtare të Sigurisë, organizuar nga ICTS Albania.

jemi ndërmjetës të kësaj tryeze diskutimesh. Në emër të Autoritetit të Aviacionit Civil, gjej rastin të rikonfirmoj mbështetjen institucionale për operatorin e aeroportit, shoqëritë ajrore, ofruesin e shërbimeve të lundrimit ajror dhe të gjitha subjektet e tjera të industrisë dhe gjen rastin t'i falenderoj për punën e kryer. Në përfundim, shpresoj shumë që përmes diskutimeve midis ekspertëve të fushës prezent këtu por edhe në vazhdim midis jush të evidentohet situata aktuale, zhvillimet më të fundit dhe sfidat kombëtare dhe ndërkombëtare dhe të nxirren përfundime të dobishme për përmirësimin e situatës në interes të sigurisë së pasagjerëve që zgjedhin të udhëtojnë me transport ajror.



KANADA: ORGANIZATA NDËRKOMBËTARE E AVIACIONIT CIVIL ZHVILLON JAVËN E SIGURISË

Drejtori i AAC Krislen Keri mori pjesë në punimet e mbledhjes së rëndësishme në kuadër të Javës së Sigurisë që u zhvillua në zyrat qendrore të ICAO-s në Montreal, Kanada. Përgjatë kësaj jave u zhvillua një ditë dedikuar industrisë me aktivitete për të adresuar sfidat ekzistuese dhe të ardhshme lidhur me teknologjinë e sigurisë dhe inovacionit. Duke ritheksuar rëndësinë e sigurisë në aviacion si dhe në sistemin e përgjithshëm të sigurisë globale në aviacion, kërcënimet e vazhdueshme dhe sfidat në këtë konferencë u theksua:



1. Terrorizmi global dhe kërcënimet në operimet e transportit ajror ndërkombëtar si kërcënimet e brendshme dhe kibernetike vazhdojnë të ekzistojnë dhe evoluojnë dhe duhet të adresohen, duke marrë në konsideratë rritjen e numrit të pasagjerëve.
2. Ndërgjegjësimi për kërcënimet e direkt dhe indirekte.
3. Mbështetja e fuqishme për implementimin e Planit Global të Sigurisë në Aviacion të njohur si GAsEP, i cili ka hyrë në fuqi në Nëntor 2017 si dhe konferencat e mbajtura në Egjipt, Panama, Portugali dhe Tajlandë.

4. GAsEP ofron një mundësi për të fuqizuar objektivat dhe metodologjitë e USAP
5. Aneksi 17, i cili i referohet kapitullit të Sigurisë përmban kryesisht masa të cilat i adresohen aviacionit civil. Komponentët e lidhur me sigurinë në Aneksin 9 të njohur si kapitulli i Lehtësimit përdorin API (Informacionin e Avancuar për Pasagjerët) dhe PNR (Rekordi i Emrit të Pasagjerëve) janë efektive në parandalimin e terroristëve dhe kriminelëve të tjerë nga arritja e kryerjes së një veprimi të dëmshëm.
6. Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara njeh rëndësinë e vënies së theksit të sigurisë në aviacion për tu përballur me kërcënimet terroriste ndaj aviacionit civil ndërkombëtar dhe për të adresuar çështjen e luftëtarëve të huaj, që i bashkohen grupeve terroriste, me miratimin e UNSC Rezoluta 2309 në Shtator të 2016 si dhe Rezoluta 2396 në Dhjetor të 2017.
7. Koordinimi i mëtejshëm mes ICAO-s dhe OKB-s për të kontribuar në një qasje globale.
8. Të gjithë aktorët të bashkëpunojnë për të zhvilluar qasje të reja dhe inovative për të forcuar sigurinë në aviacion dhe për të përballuar sfidat që sjell terrorizmi.



Në foto:
Drejtori i AAC, z. Krislen Keri, sëbashku me Sekretaren e Përgjithshme të ICAO-s, Dr. Fang Liu

KANADA: ORGANIZATA NDËRKOMBËTARE E AVIACIONIT CIVIL ZHVILLON JAVËN E SIGURISË

Drejtori Ekzekutiv i AAC-së, z. Krislen Keri mori fjalën në emër të Shqipërisë në diskutimin referuar Qasjeve të së ardhmes në menaxhimin e sfidave të sigurisë, duke ritheksuar rëndësinë e rolit të Sekretariatit si të fuqizimit të qëndrueshmërisë të sigurisë në aviacion si dhe duke shprehur miratimin e tij ndaj propozimeve të organizatës IATA, në kuadër të përfshirjes së të gjithë aktorëve në AVSEC në qëllimin e ndërgjegjësimit të kulturës së AVSEC. Në mbledhje z. Keri u takua edhe me Sekretaren e Përgjithshme të ICAOs zonjën Fang Liu, të cilën e njohu me zhvillimet në aviacionin civil shqiptar. Në mbledhje gjithashtu u theksua nevoja e shteteve për të promovuar kulturën e sigurisë. Rëndësia e qëndrueshmërisë dhe mirëmbajtjes së sistemit të sigurisë. Shkëmbim informacioni lidhur me praktikën e mira në fushën e sigurisë kibernetike. Keri në fjalën e tij, vlerësoi propozimin e Irlandës për të themeluar një sistem të raportimit më eficient për të lehtësuar analiza efektive si dhe promovimit të kulturës së raportimit dhe shkëmbimit të informacioneve. Gjithashtu vlerësoi propozime të disa shteteve si Singapori, Belgjika, Kanada, Gjermania, Italia, Zelanda e Re, SHBA etj në kuadër të nevojës për trajnim dhe kualifikim në rritjen e kapaciteteve të gjithë aktorëve aktivë, në fushën e sigurisë së aviacionit. Gjithashtu z. Keri theksoi

mbështetjen e tij për rritjen e kulturës së sigurisë dhe në mirë administrimin e sistemit të kontrollit të kufijve përmes përditësimit të informacionit dhe inkurajimit të shteteve për të bashkëpunuar në zhvillimin e programeve adekuate në këtë fushë. Keri, ritheksoi qëndrimin e Shqipërisë në kuadër të inkurajimit të shteteve në krijimin e partneriteteve të agjencive të ndryshme për tu përballur me kërcënimet në fushën e sigurisë në aeroporte dhe "on board". Duke konkluduar z. Keri ritheksoi rëndësinë e bashkëpunimit të sigurisë, fasilitimit, parrezikshmërisë dhe bashkëpunimit me të gjithë aktorët në fushën e sigurisë në aviacion për të arritur një qasje të koordinuar kundër terrorizmit. Në këtë event morën pjesë vendim-marrës dhe aktorë të industrisë. Kjo konferencë u ndoq nga 540 pjesëmarrës duke përfaqësuar 107 vende anëtare, 22 organizata ndërkombëtare dhe rajonale si dhe të industrisë.

ICAO AVSEC 2018

2nd Global AVSEC Symposium 2018



Foto:
gjatë Mbledhjes së "Second High-level Conference on Aviation Security",
Montreal - Kanada

KLIK EKSPLO GROUP & TIRANA INTERNATIONAL FAIR: AAC, VIJON TRADITËN DUKE MARRË PJESË NË PANAIR

Autoriteti i Aviacionit Civil ka vazhduar traditën e vendosur tashmë prej vitesh, duke marrë pjesë edhe në këtë vit në Panairin Klik Ekspo, të organizuar në Pallatin e Kongreseve dhe me pjesëmarrjen e shumë institucioneve shtetërore dhe një numri të madh të bizneseve vendase, rajonit dhe ndërkombëtare. Në këtë vit AAC zgjodhi që tema kryesore në këtë panair ti kushtojë punës që është bërë për të drejtat e pasagjerit, por gjithashtu stenda u shfrytëzua për të njohur edhe shumë qytetarë me të drejtat që ata kanë në rastet

kur fluturimi i tyre shtyhet apo anulohet, por edhe në rastet kur dëmtohet apo humbet bagazhi. Stenda e Autoritetit të Aviacionit Civil, ngjalli një interes të madh duke u vizituar nga rreth 500 persona që merrnin informacion për çështje të ndryshme. Një risi e këtij viti ishte edhe printimi në formën e një reviste e përmbledhjeve të buletineve që janë publikuar deri më tani me rreth 60 faqe, ku shumë vizitorë e morën për tu njohur më në detaje me aktivitetet e AAC. Në këtë stendë përveç ekspertëve të AAC, ishin të pranishëm edhe të rinjtë pjesë e programit të praktikës vendosur me vendim të Këshillit të Ministrave, që gjithashtu folën për eksperiencën e tyre disa mujore në institucion.



Në foto:
stenda e AAC gjatë ditëve të panairit Klik Ekspo Group & Tirana International Fair



Në foto:
vizitorë të ndryshëm pranë stendës së AAC përgjatë ditëve të panairit Klik Ekspo Group & Tirana International Fair



KOMPENSIME

SHKON NË 700 NUMRI I KOMPENSIMEVE

SHKON NË 700 NUMRI I KOMPENSIMEVE NGA KOMPANITË AJRORE. KOMPANIA BLUE PANORAMA REZULTON ME NUMRIN MË TË LARTË TË KOMPENSIMEVE NDAJ PASAGJERËVE 509 TË TILLA. DUKE U BAZUAR NË TË DHËNAT QË AAC KA, REZULTON SE KANË PRANUAR TË KOMPENSOHEN RRETH 45% E KËRKESAVE TË PASAGJERËVE NËRKOHË QË NUMRI PRITET TË RRITET ENDE, PASI KANË FILLUAR TË TRAJTOHEN ANKESAT E VJESHTËS.



Rritet ndjeshëm numri i kompensimeve që pasagjerët kanë përfituar nga vonesat mbi 2 orë apo anulimet e fluturimeve që kanë ndodhur në Aeroportin Nënë Tereza në 5 muajt e fundit. Nga të dhënat që sektori i pasagjerëve në TIA ka marrë nga kompanitë ajrore, rezultojnë se numri i personave që u janë pranuar kërkesat e ankimit është rritur duke shkuar në 700 kompensime nga 250 euro, ose me bileta të reja avioni në rreth një vit. Duke u bazuar në këto shifra rezultojnë se janë pranuar rreth 45 % e ankesave të ardhura nga pasagjerëve që kanë hasur probleme në udhëtimin e tyre. Nga analiza e të dhënave rezultojnë se nga muaji Tetor në Nëntor numri është rritur me rreth 200 kompensime më shumë. Sipas të dhënave rezultojnë se kompania që ka edhe numrin më të lartë të kompensimeve është Blue Panorama, me 509 kompensime në total. Ndërkohë kanë filluar trajtimet e ankesave për ngjarjet e datës 02-03 Shtator 2018. FLY ERNEST Vazhdon të jetë në numrin 96 total, ndërkohë kjo kompani duke shfrytëzuar edhe legjislacionin europian nuk ju është përgjigjur ende pasagjerëve që kanë regjistruar probleme gjatë stinës së verës dhe vjeshtës. Çështje për të cilën Autoriteti i Aviacionit Civil shqiptar ka vënë në dijeni edhe Autoritetin e Aviacionit Civil në Itali dhe Komisionin Europian, që janë duke e ndjekur situatën. Kompania Ajrore Albawings ka dërguar informacion mbi trajtimin e ankesave të pasagjerëve dhe rezultojnë se ka pranuar 31 raste në total, ndërkohë sapo ka filluar të trajtojë edhe ankesat e stinës së vjeshtës. Kompania LUFTHANSA, nga të dhënat që ka referuar referon për një numër që në total shkon në 32 pasagjerë. Austriakja AUSTRIAN AIRLINES ka kryer gjithsej 12 kompensime. AIR SERBIA, 2 kompensime. Ndërsa kompanitë e tjera rreth 16 në total. Shifra inkurajuese ka ardhur falë një pune të përditshme nga sektori i pasagjerëve që funksionon prej disa muajsh në Aeroportin Ndërkombëtar Nënë Tereza.



AAC i bën thirrje gjithë personave që kanë plotësuar formularët e ankimit dhe ka kaluar afati prej 6 javësh, që të rikontaktojnë përsëri kompanitë ajrore që kanë patur fluturimin për tu njohur me statusin e fluturimit të tyre. Në rast se kompania nuk i kthen asnjë përgjigje, atëherë të kontaktojnë me sektorin e të Drejtave të Pasagjerit të AAC-së në numrat e telefonit: **+355 42 381 959 / +355 44 539 959** ose me email tek: **pax@acaa.gov.al** dhe do të marrin asistencën e nevojshme. Për më shumë informacion vizitoni gjithashtu dhe linkun e mëposhtëm:



www.aac.gov.al/te-drejtat-e-pasagjerit



AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL

ANALIZA STATISTIKORE PËR MUAJIN TETOR 2018


■ **TETOR 2018:** Bazuar në të dhënat zyrtare muaji Tetor ka vijuar të ketë një numër të madh pasagjerësh që kanë udhëtuar për/nga Aeroporti Ndërkombëtar Nënë Tereza, krahasuar me të njëjtën periudhë të viteve të mëparshme. Kështu rezultoi se në muajin Tetor janë regjistruar 226,351 pasagjerë, 10,329 pasagjerë më shumë se e njëjta periudhë e 2017. Krahasuar me 2016, shifra është 26,048 pasagjerë më shumë.

■ **PËRQINDJET:** Bazuar në të dhënat, kompania ajrore "Blue Panorama" është mbizotëruese në treg duke mbuluar fluksin më të madh të lëvizjes së pasagjerëve për muajin Tetor 2018, me një numër prej 47,948 pasagjerësh ose 21% të totalit. Ndjekur nga Ernest S.p.A me 13% ndaj totalit me 30,342 pasagjerë, duke vijuar me dy kompanitë "Albawings" dhe "Alitalia" secila me 10% ndaj totalit.


Grafiku në të djathtë paraqet fluksin e pasagjerëve që kanë udhëtuar përgjatë muajit Tetor 2018, të ndarë sipas kompanive ajrore.

Përqindjen më të madhe të tregut në transportin ajror për muajin Tetor 2018 vazhdon ta zotërojë Italia, duke zënë 54% të totalit, ndjekur nga dy kompanitë Turke me 10% në total.

Grafiku 1:
Lëvizja e pasagjerëve e ndarë në % sipas operatorëve ajrorë, që kanë udhëtuar për/nga TIA gjatë muajit Tetor 2018.



■ **CHARTER:** Fluturimet Charter për muajin Tetor 2018 rezultojnë në një numër prej 1796 pasagjerësh, shifër kjo 22% më e lartë se një vit më parë.




Grafiku 2:
Grafiku paraqet krahasimin e numrit të pasagjerëve të muajit Tetor 2018 kundrejt së njëjtës periudhë të vitit 2016 dhe 2017

ANALIZA STATISTIKORE PËR MUAJIN TETOR 2018

KOMPANITË AJRORE:

Tabela në të djathtë jep një informacion të plotë krahasimor për muajin Tetor të tre viteve të fundit të numrit të pasagjerëve sipas shoqërive ajrore.



Grafiku 3:
Grafiku paraqet krahasimin e numrit të pasagjerëve të muajit Tetor 2018 kundrejt së njëjtës periudhë të vitit 2016 dhe 2017 sipas shoqërive ajrore

RAPORTI I PERFORMANCËS

MUAJI NËNTOR

Situata e vonesave dhe anulimeve për muajin Nëntor, është e qetë dhe nuk paraqitet problematike si muajt e mëparshëm. Kjo për shkak të uljes së fluksit të udhëtarëve jo vetëm në Shqipëri por edhe në vendet e tjera Europiane. Më poshtë edhe tabela përkatëse për situatën e Nëntorit.

Në tabelën në të djathtë paraqiten edhe numrat e saktë me vonesa dhe anulime të fluturimeve gjatë muajit Nëntor 2018.

KOMPANIA	VONESA/ANULLIME	
ALBAWINGS	Vonesa mbi 2 orë	2
	Anulime	
ERNEST	Vonesa mbi 2 orë	1
	Anulime	
WIZZ AIR	Vonesa mbi 2 orë	1
	Anulime	
ALITALIA	Vonesa mbi 2 orë	1
	Anulime	
ADRIA	Vonesa mbi 2 orë	1
	Anulime	
AIR SERBIA	Vonesa mbi 2 orë	1
	Anulime	
LUFTHANSA	Vonesa mbi 2 orë	1
	Anulime	
TURKISH	Vonesa mbi 2 orë	1
	Anulime	
WIZZ AIR	Vonesa mbi 2 orë	1
	Anulime	
BLUE PANORAMA	Vonesa mbi 2 orë	
	Anulime	
AEGEAN AIR	Vonesa mbi 2 orë	
	Anulime	
PEGASUS	Vonesa mbi 2 orë	
	Anulime	
BRITISH AIRWAYS	Vonesa mbi 2 orë	
	Anulime	
VOLOTEA	Vonesa mbi 2 orë	
	Anulime	
TRANSAVIA	Vonesa mbi 2 orë	
	Anulime	
AUSTRIAN	Vonesa mbi 2 orë	
	Anulime	

Tabela përkatëse

AKTIVITETE TË DREJTORIVE TË AUTORITETIT TË AVIACIONIT CIVIL GJATË MUAJIT NËNTOR

AAC ZHVILLOHET TRAJNIMI NGA EKSPERTËT LIGJOR TË JAATO

Në Autoritetin e Aviacionit Civil shqiptar u zhvillua kursi i radhës me temë "International Aviation Law Policy" me pjesëmarrës specialistë të AAC-së në kuadër të strategjisë për rritjen e kapaciteteve të stafit të brendshëm. Ky kurs u zhvillua për disa ditë dhe u dha nga një prej eksperteve më të mira në BE në fushën e ligjit në aviacion. Kursi trajtoi backgroundin dhe rregulloret e transportit ajror ndërkombëtar, zhvillimet

në kuadrin rregullator në BE, ICAO dhe entitete të tjera të fushës së aviacionit civil. Ky trajnim ishte vijimi i projektit me organizatën prestigjiozë të trajnimeve JAA TO e përshtatur për nevojat e Autoritetit të Aviacionit Civil Shqiptar, duke ofruar trajnim të stafit dhe përmirësim të kapaciteteve brenda vendit.



Në foto:
gjatë trajnimit që u zhvillua në Tiranë ekspertja e JAA TO me specialistët e AAC, me temë "International Aviation Law Policy"

AAC DHE EUROCONTROL KANË ZHVILLUAR NJË SEMINAR TË RËNDËSISHËM

Me iniciativën e AAC dhe në bashkëpunim me Eurocontrol, në datën 8 Nëntor 2018 në Tiranë u zhvillua seminari në lidhje me implementimin e rregullave të reja të licencimit për Kontrollorët e Menaxhimit të Trafikut Ajror në përputhje me Rregulloren e re të Komisionit European Nr. 340/2015. Në këtë Seminar morën pjesë specialistë nga Autoriteti i Aviacionit Civil, Albcontrol dhe mjekë në lidhje me ekzaminimet mjekësore për personelin e lidhur me shërbimet aeronautike.

Në seminar u diskutuan në detaje rregullat e detajuara për:

1. Kushtet në lëshimin, pezullimin dhe revokimin e licencave, vlerësimeve përkatëse dhe miratimeve të kontrollorëve

të trafikut ajror dhe të student-kontrollorëve të trafikut ajror si dhe privilegjet dhe përgjegjësitë e atyre që i mbajnë ato;

2. Kushtet për lëshimin, kufizimin, pezullimin dhe revokimin e certifikatave mjekësore të kontrollorëve të trafikut ajror dhe të student-kontrollorëve të trafikut ajror, privilegjet si dhe përgjegjësitë e atyre që i mbajnë ato;

3. Certifikimin e ekzaminuesve aero-mjekësor dhe qendrave aero-mjekësore për kontrollorët e trafikut ajror dhe student-kontrollorët e trafikut ajror;

4. Certifikimin e organizatave trajnuese të kontrollorit të trafikut ajror;

5. kushtet për vleftësimin, rivleftësimin, rinovimin dhe përdorimin e këtyre licencave dhe certifikatave.

Si konkluzion mund të themi se

Seminari arriti pritshmërinë në lidhje me këtë rregullore që do ti shërbejë arritjes së disa qëllimeve si :

a. përgatitjen e bazës rregullative për ushtrimin e kushteve të licensës për Kontrollorë të Trafikut Ajror dhe Ekzaminuesve aero-mjekësor për personelin e lidhur shërbimet aeronautike,

b. përgatitjen e procedurave mbikëqyrëse për proceset e licencimit,

c. përgatitjen e procedurave të punës të ofruesit të shërbimeve navigacionale në lidhje me mbajtjen e kushteve të licencimit të Kontrollorëve të Trafikut Ajror. Autoriteti i Aviacionit Civil i kushton një rëndësi të veçantë përditësimit të legjislacionit vendas me atë European, në kuadrin e synimeve të vendit tonë për tu integruar në BE.